Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI

PROCESVERBAL
Mbajtur më 25 maj 2026
Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit dhe filloi në orën 10:10
Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës.
Në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e KKSB-së: **z.Bashkim Bajrami**,Komandant i Stacionit të Policisë; z.**Gjergj Uka**, përfaqësues i Kishës Protestante-Podujevë; z. **Fitim Sejdiu**, përfaqësues i Komunitetit Ashkali; z. **Enver Rama**,përfaqësues i Komunitetit Rom; znj.**Naime Podvorica**, zyrtare për Barazi Gjinore; z.**Avni Fetahu**, drejtor i Drejtorisë së Arsimit; z.**Nazif Sheqa**, kryetar i Këshillit të Prindërve të Arsimit – Podujevë;z.**Qefser Behrami**, përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike – Kërpimeh; z.**Bahri Selimi**, përfaqësues i Emergjencave Civile ; z.**Liman Zeqiri**, përfaqësues i Zyrës komunale për Komunitete dhe Kthim; znj.**Sabrie Bislimi**, përfaqësuese e OJQ-ve;

Ndërkaq munguan: z.**Mensur Hoti**, përfaqësues i Këshillit të Bashkësisë lslame z. **Ymerdin Hasani,** përfaqësues i FSK-së; znj.**Sevdije Mustafa**, përfaqësuese e Komunitetit Egjiptian; z.**Naim Bajrami**, përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike – Orllan; z.**Granit Thaqi**, përfaqësues i Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi; z.**Rozafat Maloku**, përfaqësues i Mediave Lokale; z.**Afrim Fazlija**, përfaqësues i Komunitetit të Biznesit dhe z.**Idriz Hoxha**, përfaqësues i Komunitetit të Personave me Aftësi të Kufizuara.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi.

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, përshëndetje për të gjithëve. Po hap takimin e KKSB-së. Në bazë të Udhëzimit Administrativ nr. 27/2012 MPB – 03/2012 MAPPL kemi paraparë këtë rend dite dhe materialin për mbledhje konsideroj e keni marrë të gjithë me kohë, kështu që e vë në votim për miratim këto pika të rendit të ditës nëse eventualisht nuk ka dikush diçka për të shtuar.

Rendi i Ditës
Rendi i ditës u miratua njëzëri.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 17 prill 2026
U miratua njëzëri

2. Raporti i Policisë së Kosovës për gjendjen e sigurisë në komunë
- **Informatë nga përfaqësuesi i KFOR-i për sigurinë në komunë**
- **Informatë nga përfaqësuesi i FSK-së për sigurinë në komunë**

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, fillimisht fjalën e ka Komandanti i Stacionit të Policisë z. Bashkim Bajrami.
z. Bashkim Bajrami, theksoi, situata e sigurisë në zonën tonë të përgjegjësisë është e qetë dhe stabile, pa ndonjë indikacion për përkeqësim të saj. Ka pasur numër të konsiderueshëm të rasteve

të ndryshme të raportuara, por të cilat nuk kanë ndikuar në përkeqësimin e situatës së përgjithshme.
Fokusi ynë gjatë kësaj periudhe kohore ka qenë sigurimi i një ambienti të qetë për të gjithë qytetarët, parandalimi i kryerjes së veprave të ndryshme kriminale, arrestimi i personave që kanë kryer vepra të ndryshme, apo kanë rënë ndesh me ligjin. Për të realizuar detyrat tona të përditshme në ruajtjen e rendit dhe të qetësisë publike, kemi planifikuar dhe organizuar plane të ndryshme operative qoftë në parandalim të aksidenteve të trafikut apo parandalimin dhe zbulimin e veprave të ndryshme penale. Në aspektin e krijimit të një mjedisi më të qetë dhe ofrimit të sigurisë për qytetarët ne kemi në implementim Strategjinë Policia në Bashkësi dhe Policia e Udhëhequr nga Inteligjenca që nënkupton :

-Rritja e patrullimeve më cilësore në Sektorë si dhe prezencës policore duke u angazhuar në Pika Kontrolli, Patrullime Këmbë, Patrullime në Vende të Frekuentuara, Patrullime në Afërsi të Institucioneve Arsimore etj.
Gjatë kësaj periudhe kohore kemi në implementim planet operative siç janë:
-Kulti,
-Siguria në trafikun rrugor,
-Siguria në shkolla,
-Sezona Verore,
-Realizimi i Urdhëresave të Gjykatës,
-Masat e sigurisë tek Burgu i Sigurisë së Lartë,
-Parandalimi dhe luftimi kundër shkatërrimit të mjedisit në RKS,
-Parandalimi i Grabitjeve,
-Masat e shtuara të sigurisë dhe veprimeve policore,
-Gatishmëria Vepruese për kërcenimet me Bomba,
-Ngritja e Vigjilencës

Sa i përket trafikut në qytet, kemi ridizajnuar një plan të angazhimit që do të mbulojë me zyrtarë policor katër rrugët më të frekuentuara në qytet me një njësi policore: rruga nga pranvera 99 deri te rrethi i Shqiponjës, rruga kah gjykata-emergjenca, rrethi i Kerpimehit-taksit e dumnicës, rruga kah ish elektrokosova. Do të ketë monitorim më strikt në drejtim të realizimit të këtij plani në mënyrë që të kemi një qytet më të lirshëm për qarkullim nga veturat.
Gjatë kësaj periudhe 01.04-15.05.2026 kemi të iniciuara 169 raste, prej tyre vepra penale119, incidente dhe aksidente 50, vjedhje 9, vjedhje e rëndë 5, dhunë familjare 16, numri i incidenteve në shkolla 4, urdhëresa të realizuara 24, aksidente me fatalitet 1, aksidente me të lënduar 9, aksidente me dëme materiale 49, numri i tiketave të shqiptuara 1112. Prej këtyre rasteve në prokurori i kemi përcjell 75, ndërsa nën hetime janë 37, raste të transferuara te njësitë tjera 6. Gjatë trajtimit të këtyre rasteve kemi konfiskuar dhjetë (10) armë zjarri, dyzet e tre (43) fishek, gjashtë (6) thika, dy (2) boksa metali, dhe dymbëdhjetë (12) raste substancë narkotike.
Gjatë kësaj periudhe po ashtu është vazhduar edhe me ligjëratat e zyrtarëve policor në tetëmbëdhjetë (18) shkolla me temat: parandalimi i ngacmimeve seksuale dhe siguria në trafik, ku janë të përfshirë 2078 nxënës. Gjatë kësaj periudhe kemi pasur 25 plane operative, 7 asistime policore, ndërsa në shënime zyrtare kanë mbetur 69 dhe kemi pasur 555 raporte të Policisë.
Te aspekti i urdhëresave të realizuara gjatë kësaj periudhe kemi pranuar 22 urdhëresa të reja, të realizuara janë 24, ndërsa urdhëresa të parashkruara janë 6.
Ky ishte një raport i shkurtër në mënyrë statistikore lidhur me situatën e përgjithshme të sigurisë në zonë tonë.
z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, faleminderit Komandant për informatën e paraqitur për gjendjen e sigurisë në Komunën e Podujevës. Përfaqësuesi i KFOR-it duket se mungon, ndërsa nga FSK përmes një emaili na kanë njoftuar se kanë angazhime tjera dhe nuk mund të marrin pjesë në takim. Meqë Komandanti e mbaroi diskutimin e tij e hap diskutimin lidhur me këtë pikë.

z. Gjergj Uka, theksoi, kam një pyetje për Komandantin e Stacionit të Policisë, në vendin e ri ku jeni vendos aty në hyrje qytetarët po parkohen dhe po gjobiten, a ka mundësi që të vendoset ndonjë shenjë e trafikut në mënyrë që mos të gjobiten.
z. Bashkim Bajrami, theksoi, nëse e keni fjalën për Stacionin e ri , ish objektin e Komunës ku është zhvendosur Stacioni i Policisë aty ekziston shenja e trafikut që është vendosur. Më parë nuk kemi shqiptuar asnjë gjobë aty, ndërsa tash e tutje aty është vend i rezervuar për automjete të Policisë dhe varësisht prej shenjës kjo duhet respektuar dhe do të shqiptohen gjobat.
z. Fitim Sejdiu, përshëndetje për të gjithë, theksoi, kam një kërkesë, meqenëse jemi pran festës së Kurban Bajramit kërkoj nga institucionet të ndërmarrin masa preventive rreth hedhjes së mbeturinave për shkak se kemi qen endacak. Sa i përket komunitetit tonë deri sot nuk ka pas ndonjë rast të veçantë.
z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, tashmë Drejtoria e Inspeksionit ka marr masat lidhur me këtë datë, inspektorët do të jenë në terren dhe nuk besoj se do të kemi telashe të tilla.
z. Bashkim Bajrami, theksoi, lidhur me këtë pikë kemi bashkëpunim me Drejtorinë e Inspeksionit dhe kemi hartuar një plan të përbashkët operativ për të vepruar.
z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi nëse nuk ka tjerë të interesuar të marrin fjalën rreth kësaj pike, kalojmë në pikën e radhës.

3. Miratimi i Planit të punës së KKSB-së për vitin 2026

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi Grupi punues i cili është formuar për hartimin e këtij plani, kanë hartuar kalendarin e aktiviteteve të rregullta të KKSB-së të cilin e keni si pjesë e materialit. Unë nuk do të lëshohem në përsëritjen e këtyre aktiviteteve, por hap diskutimin lidhur me këtë pikë. Fillimisht fjalën e ka z. Avni Fetahu, i cili ka qenë edhe koordinator i grupit.
z. Avni Fetahu, theksoi, ashtu siç e potencoi edhe Kryetari ky ka qenë një grup punues me një numër bukur të madh të anëtarëve të KKSB-së, të cilët kanë dhënë idetë e tyre kështu që është një kalendar me njëzet e dy (22) aktivitete dhe urojmë të realizohet me përpikëri ashtu siç është paraparë. Nëse dikush që ska qenë prezent gjatë përgatitjes së draftit e don të shtojë ndonjë pikë, jemi të hapur, sepse dokumenti pas aprovimit në këtë takim do të procedohet për aprovim në Kuvendin e Komunës.
z. Fitim Sejdiu, theksoi, do të propozoja një pikë në kalendarin e aktiviteve, me temë që të dalim në terren, ti shohim gjërat apo situatën drejtpërsëdrejti.
z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, propozimi për dalje në terren, besoj se kjo është e drejtë e Këshillit në çdo moment që e vlerëson se ka nevojë për ndonjë problematikë për të dal në terren për të parë diçka, dhe besoj se këtu nuk ka kurrfarë pengese, qoftë nëse parashihet këtu si pikë apo jo, kjo është diçka që mund të realizohet konformë kërkesave të cilit do prej anëtarëve të Këshillit. Dikush tjetër.
z. Liman Zeqiri, theksoi, ne e kemi paraparë në plan program që shumë prej këtyre çështjeve që u theksuan janë të përfshira, nga to edhe vlerësimin tonë në terren për të verifikuar gjendjen faktike, pra është paraparë me plan pune si pikë e rendit të ditës.
z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, atëherë nëse nuk ka dikush për të shtuar diçka tjetër e vë në votim Planin e Punës së KKSB-së dhe mendoj që ta procedojmë në këtë mbledhje të KPF-së në mënyrë që të rekomandohet si pikë urgjente për shqyrtim dhe aprovim në këtë mbledhje të Kuvendit.

Konstatim:
Propozimi i Planit të punës së KKSB-së për vitin 2026 aprovohet njëzëri nga KKSB dhe i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

3. Të ndryshme

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi para se të hap diskutimin dua të ju informojë që duke pas parasysh edhe angazhimet e mia, ndodh që të mungoj në ndonjë takim të KKSB-së, atëherë kisha propozuar që si koordinator të këtij Këshilli të jetë z. Bahri Selimi, duke qenë se sektori i emergjencave dhe sigurisë është në kuadër të Drejtorisë së tij. Në rast të mungesës time z. Bahri Selimi mund të udhëheqë këto takime edhe pse unë do të bëjë përpjekje të jem i rregullt në këto takime. E vë në votim propozim.

Konstatim
Pas procesit të votimit njëzëri u miratua propozimi i Kryetarit të Komunës që z. Bahri Selimi caktohet koordinator i KKSB-së.

Hap diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës.
z. Liman Zeqiri, theksoi respekt për Drejtorin Bahri Selimi, i kuptojmë situatën dhe rrethanat por ndoshta në këtë Këshill ka tema emergjente që shtrohen për shkak të situatave dhe pa keqkuptim Drejtori është në kuadër të këtyre kompetencave dhe përgjegjësive, pra këto tema sillen te Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit ku si sektor hynë emergjenca dhe plotësisht jam i pajtimit që de fakto dhe de jure në rast të mungesës së Kryetarit këto takime ti kryesoj Drejtori, sepse edhe ashtu e meriton sepse është shumë aktiv.
z. Qefser Behrami, dua të diskutoj një ngjarje, ku dje isha edhe vet prezentë. Një banor i fshatit Uglar ku kam respekt për, i cili vetëm me qëllimin që të ndihmojë banorët e asaj pjese por edhe më gjerë ka bërë furnizimin me ujë të pijes diku rreth 1200 m gjatësi, që gjendet një distancë shumë e vogël mbi restorantin e Reçicës, e aktualisht është duke punuar në ndërtimin e mbulojës, aty ku njerëzit furnizohen me ujë. Për atë ujë janë bërë analiza dhe ka rezultuar se është i pijes dhe shumë cilësor duke marr përbazë parametrat e analizave. Derisa isha prezentë aty duku rreth njëzet (20) persona veç se erdhën për tu furnizuar me ujë nga aty. Por ajo që desha ta theksoj është se një fermer nga fshati Reçicë ka shkarkuar plehra të bagëtisë në atë vend, te uji i pijes. Kërkesa është nëse ka mundësi të ndërmerren masa nga ana e Drejtorisë së Inspeksionit lidhur me këtë çështje.
I nderuari Kryetar, ke fituar respekt te veçantë te banorët e asaj pjese me angazhimet dhe me punën që keni bërë në veçanti për projektin e fundit çka do të thotë se edhe ai projekt është i mirëpritur prej komunitetit të asaj pjese. Po e përsëris, me punën keni fituar një simpati dhe ke hyrë në zemrat e banorëve të asaj zone. Kam edhe një çështje tjetër, në hyrje të fshatit Dvorishtë janë disa shenja për rrezikshmëri të komunikacionit, pse të mos ndërmerret diçka për të rregulluar atë pjesë të rrugës, sepse aty ku është shembur mundet të vijë deri një rrezikshmëri shumë e madhe.
z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, faleminderit shumë Qefser, po bëj përpjekje që të jap përgjigje. Fillimisht për hedhjen e plehrave, tash menjëherë pas përfundimit të takimit kontakto Drejtorin e Drejtorisë së inspeksionit dhe lajmëro këtë rast. Inspeksioni do të dal atje dhe do të merret me këtë çështje. Sa i përket fshatit Dvorishtë këtë çështje e merr për obligim Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit dhe do të kontaktojë zyrtarët e Ministrisë së Infrastrukturës, sepse rruga është e nivelit regjional dhe mbikëqyret nga Ministria. E merr përsipër dhe e dërgon ankesën edhe për dheun që ka rrëshqit e ka ra në rrugë, për ta larguar, por njëkohësisht edhe për të bërë sanimin e asaj pjese. Për këtë nuk është se nuk kemi diskutuar, kemi diskutuar sa e sa herë me Ministrinë por nuk ka pas veprime nga ana e tyre, por shpresoj që pasi që jemi edhe në kohë fushate dhe do të dalin ta shikojnë dhe ta mënjanojnë atë defekt që është atje.
Nëse nuk ka dikush tjetër diçka për të shtuar atëherë ju falënderoj shumë të gjithëve për kontributin. Mirupafshim në takimin e radhës.

Mbledhja përfundoi në orën 10.35
Procesverbalin e mbajti
Sabedin Namani

Nr. prot. 02-060/04-0030296/26
Podujevë, datë: 25.05.2026

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi